



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. 16333/10782/6221/3433 regj.themeltar

Nr. 210 vendimi

Dt. 05.02.2020

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata Administrative e Apelit me trup gjykues të përbërë nga:

Kryesuese: Alkelina Gazidedja
Anëtar: Amarildo Laçi
Anëtar: Bari Shyti

Asistuar nga sekretarja gjyqësore [REDACTED] sot më dt. 05.02.2020 mori në shqyrtim në dhomë këshillimi çështjen administrative me palë:

PADITËS: Shoqëria “Ujësjiellës Kanalizime Tiranë” sh.a.

TË PADITUR: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

OBJEKTI: Kundërshtimin dhe shfuqizimin e vendimit nr. 165, datë 14.11.2016 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me nr. 95/4 prot, datë 14.11.2016, protokolluar me tonën nr. 23159, datë 15.11.2016.

BAZA LIGJORE: Nenet 31, 154, 324, 327, 328, 331, 676, të Kodit të Procedurës Civile, nenet 4, 13, 47, 56, 113, 115, 117, të Kodit të Procedurave Administrative, nenet 12, 21, 24, 141, 143-154, 148, 153 dhe 154, të Kodit të Punës, ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, pasi ka marrë në shqyrtim çështjen me Vendimin Nr. 970 (80-2017-996), Dt.13.03.2017, ka vendosur:

- Pranimin e padisë së palës paditëse “Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a.

- Shfuqizimin e vendimit nr. 165, datë 14.11.2016 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Ky vendim përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutimi i detyrueshëm bëhet nga përmbaruesi gjyqësor.
- Shpenzimet gjyqësore janë në ngarkim të palës së paditur.
- Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë brenda 15 ditëve nga e nesërmja e shpalljes. Për Avokaturën e Shtetit në mungesë ky afat fillon nga e nesërmja e njoftimit të vendimit.

Kundër vendimit ka bërë ankim pala e paditur Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, e cila kërkon ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e padisë, duke parashtruar këto arsye:

- Ky vendim është i padrejtë dhe i marrë në kundërshtim me ligjin, pasi vendimi nr. 165 datë 29.11.2016 i Komisionerit, është një vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj. dhe si i tillë gjykata duhet të kishte vendosur rrëzimin e padisë për sa më poshtë:
- Gjykata ka argumentuar se: “Relacioni për miratimin e projekt-vendimit “Për ndryshimin e strukturës dhe organigramës së shoqërisë”, ka motivuar mbingarkesën e e administratës së shoqërisë, në raport me gjendjen e saj tekniko-financiare dhe me të cilin është paraqitur për miratim projekt-vendimi për miratimin e strukturës së re organike dhe organigramës së shoqërisë. Komisioneri e kundërshton këtë arsytim, pasi me anë të këtij projekt-vendimi është bërë e mundur ulja e numrit të punonjësve nga 1300 të ulet në 863 punonjës dhe qartazi siç është përmendur në këtë relation, shkak kryesor i heqjes së punonjësve janë bindjet politike. Gjykata duhet të mbante parasysh faktin që nga ana e UKT-së, ky pohim me shkrim nuk është argumentuar as hedhur poshtë me prova nga UKT-ja gjatë shqyrtimit administrativ. UKT-ja ka argumentuar se nuk i dinte bindjet politike të punonjësve, pasi një gjë e tillë nuk cilësohet në dosjen personale. Ky argument bie poshtë, pasi po t’i referohemi shkresës së sipërcituar të drejtorit të UKT-së kjo vërteton të kundërtën.
- Gjykata e ka argumentuar largimin e znj. [REDAKTUAR] si pushim kolektiv nga puna. KMD e kundërshton këtë argument si më poshtë: Nëse do ishte në situatën e pushimit kolektiv, lidhur me rastin e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës me ankuesen, UKT-ja do të duhej t’i kishte dhënë përparësi rimarrjes në punë të punëmarrësve të pushuar nga puna, për arsye që nuk kanë të bëjnë me punëmarrësit, nëse ai punëson punëmarrës me kualifikim të krahasueshëm. Në rastin e znj. [REDAKTUAR] nuk është respektuar ky parashikim, pasi UKT është shprehur se ka suprimim të vendit të punës, ndërkohë që rezulton që vendi i “Specialistit” ekziston, pasi z. [REDAKTUAR] është emëruar me vendimin nr. 573 prot, datë 12.04.2016, pra pas miratimit të strukturës së re të UKT-së, me vendimin nr. 05, datë 04.04.2016 të asamblesë së përgjithshme të aksionerëve. Citohet që z. [REDAKTUAR] është “Specialist faturimi” dhe jo ekonomist, por nuk janë dhënë përshkrimet, kriteret dhe detyrat e punës për secilin pozicion, (në mënyrë që të evidentohet që janë pozicione të ndryshme pune) megjithëse është kërkuar shkresërisht.

- Po ashtu, rezulton që UKT-ja ka bërë dhe emërimë të tjera pas periudhës së pushimit kolektiv. Këtë fakt e kanë pohuar vetë edhe shkresërisht. Pra, sikundër shihet qartë, numri i punonjësve është rritur sërish në prill 2016, ndërkohë që theksojmë se ankueses i janë zgjidhur marrëdhëniet e punës në muajin janar 2016. Lidhur me këtë fakt, Komisioneri krijon dyshimin e arsyeshëm se ky ndryshim i pozicionit të punës në një pozicion që ishte parashikuar për t'u suprimuar, përveçse i paligjshëm ka qenë tendencioz dhe i qëllimshëm në dëm të ankueses.
- Gjykata nuk ka mbajtur parasysh shpërndarjen e barrës së provës në çështjet e diskriminimit. Në analizë të shkaktuar të pretenduar nga ankuesi dhe bazuar në nenin 82, pika 2, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", ku parashikohet: "Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, dhe/ose organi publik, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj".
- Të provosh një çështje diskriminimi është e vështirë, pasi autorët e diskriminimit nuk deklarojnë se ata trajtojnë dikë në mënyrë më pak të favorshme se të tjerët. Rregulli i përgjithshëm në legjislacion për barrën e provës është se, detyrimi për të vërtetuar faktet e nevojshme për të provuar pretendimin është i palës që e pohon atë. Pra kush pohon - vërteton.
- Ligji "Për mbrojtjen nga diskriminimi" në përputhje me direktivat e BE-së për mbrojtjen nga diskriminimi dhe jurisprudencën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, ka vendosur që në shqyrtimin nga gjykata të çështjeve të diskriminimit të bëhet ndarja e barrës së provës. Kështu paditësi mund të tregojë disa fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka ndodhur diskriminimi dhe barra e provës bie mbi të paditurin që të provojë të kundërtën.
- Pra, nëse faktet e prezantuara nga paditësi duken të besueshme dhe konsistente me provat në dispozicion, GJEDNJ do t'i pranojë ato si të provuara, përveçse kur i padituri paraqet një shpjegim alternativ bindës. GJEDNJ pranon si fakte ato vlerësime; "të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave... provat mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/ prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pakundërshtuara. Për më tepër niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht me veçoritë e fakteve, natyrën e pretendimit të bërë dhe me të drejtat e pretenduara".
- Në çështjen objekt të këtij gjykimi, gjykata duhet të marrë në konsideratë parashikimin që bën ligji "Për mbrojtjen nga diskriminimi" dhe jurisprudenca e GJEDNJ-së dhe GJED-së, lidhur me standartin e ndarjes së barrës së provës, duke vlerësuar të gjitha provat që mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/ prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të

pakundërshtuara. Gjykata duhet të vlerësojë lidhur me qëndrimin pasiv të palës së paditur.

- RefrUAR këtyre parashikimeve ligjor, UKT-ja duhet të sillte prova dhe parashtrime që të provonin të kundërtën e pretendimeve të ankueses. Mirëpo, gjatë komunikimit shkresor dhe verbal me Zyrën e Komisionerit, UKT-ja ka theksuar faktin se ato nuk kanë patur dijeni për bindjet politike të znj. [REDAKTUAR] duke qenë se një dokument i tillë nuk cilësohet në dosjen personale të punonjësve.
- Nga parashtrimi i fakteve dhe shqyrtimi i dokumentacionit të sjellë pranë KMD-së, Komisioneri vlerëson se, ndryshimi pozicionit të punës nga Drejtore në Specialiste është bërë i paargumentuar, në shkelje të ligjit dhe për më tepër tendencioz, duke e emëruar në një pozicion pune që shumë shpejt do të suprimohej. Pas largimit të ankueses, (janar 2016) megjithëse është cituar nga ana e UKT-së se ka shkurtim të numrit të punonjësve, rezulton që në muajin prill 2016 kemi rritje të numrit të punonjësve. Në marrjen në punë nuk i është dhënë përparësi znj. [REDAKTUAR]
- Në referim të parashikimeve të Kodit të Procedurës Administrative, (Kodi i cili është në fuqi në momentin e fillimit të procedimit administrativ, pra paraqitjes së ankesës) pavlefshëmria relative parashikohet nga neni 118 i Kodit, ku sanksionohet se: “I. Aktet administrative do të quhen relativisht të pavlefshme në kuptimin e këtij Kodi, kur ato janë nxjerrë në kundërshtim me ligjin, por megjithatë nuk janë absolutisht të pavlefshme”. Vendimi nr. 165, datë 14.11.2016, është plotësisht i ligjshëm, pasi ai është marrë në përputhje të plotë me parashikimet e LMD, ashtu siç edhe është pasqyruar më sipër. Nuk ka asnjë element që çënon ligjshmërinë, duke shkaktuar pavlefshmërinë relative. Në këtë llogjikë, vendimi nr. 165, datë 14.11.2016, nuk është në kundërshtim me përmbajtjen dhe qëllimin e ligjit (LMD-së).
- Vendimi nr. 165, datë 29.11.2016 i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është plotësisht i ligjshëm, pasi ai është marrë në përputhje të plotë me parashikimet dhe procedurën e parashikuar për nxjerrjen e tij. Nuk ka asnjë element që çënon ligjshmërinë duke shkaktuar pavlefshmërinë e tij, qoftë pavlefshmërinë absolute qoftë atë relative (i referohemi kodit të vjetër të procedurave administrative).
- Rastet e pavlefshmërisë relative të aktit administrativ parashikohen nga neni 118, i K.Pr.Administrative, ku sanksionohet se: “Aktet administrative do të quhen relativisht të pavlefshme në kuptimin e këtij kodi, kur ato janë nxjerrë në kundërshtim me ligjin, megjithatë nuk janë absolutisht të pavlefshme”. Ne nuk ndodhemi në këto kushte.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Pasi degjoi relativimin e çështjes nga gjyqtarja Alkelina Gazidedja dhe shqyrtoi çështjen në dhomë këshillimi,

VËREN

Se pranë Gjykatës Administrative të Apelit ka ardhur për gjykim çështja administrative me palë dhe objekt të sipërcituar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, në bazë të ankimit të bërë nga pala e paditur.

Gjykata së pari, verifikoi ankimin e bërë nga pala e paditur nëse i plotëson kushtet e pranueshmërisë, fakt ky që është verifikuar me vendimin datë 28.03.2017, të gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë sipas kërkesave të nenit 46 - 48/2 të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", konstatoi se ankimi i plotëson kushtet e pranueshmërisë.

Rrethanat e faktit

Nga aktet në dosje rezulton e provuar se Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka marrë në shqyrtim ankesën me nr. 8 regi, datë 19.01.2016, të znj. [REDAKTUAR] kundër Drejtorit të Përgjithshëm të UKT sh.a, me pretendimin për zgjidhjen e kontratës së punës mbi shkakun diskriminues të bindjeve politike.

Sipas informacionit të dhënë, rezulton se znj. [REDAKTUAR] ka lidhur marrëdhënien e punës me UKT-në, me datë 23.06.2006, në pozicionin e "Ekonomistes". Në rend kronologjik ajo ka ndërruar disa pozicione pune: "1. Me datë 16.01.2007, ka kaluar në detyrën e "Ekonomistes" në Sektorin e Faturimit; 2. Me datë 16.08.2008, ka ndryshuar pozicion pune duke kaluar në detyrën e "Përgjegjëses së Repartit"; 3. Me datë 16.06.2009, ka kaluar në detyrën e "Auditit të Brendshëm"; 4. Për periudhën 28.01.2013 - 11.09.2013, është komanduar "Drejtores e Departamentit të Shitjes"; 5. Gjatë periudhës 11.09.2013 - 28.10.2015, ka ushtruar detyrën e "Drejtores së Drejtorisë së Shitjes dhe Faturimit"; Me datë 15.09.2015, me anë të urdhrin nr. 430, datë 15.09.2015, është komanduar në pozicionin e "Drejtores së Departamentit të Shitjes", i cili është shfuqizuar me urdhrin nr. 430/1, datë 22.09.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të UKT-së. Drejtori i ri i UKT-së është emëruar në detyrë me datë 16.09.2015. Në më pak se 6 ditë nga fillimi i detyrës, ai ka shfuqizuar urdhrin për komandimin në detyrë të ankueses dhe në një periudhë prej vetëm një muaj nga ky shfuqizim ka ulur në detyrë znj. Hoxha, duke e kaluar nga pozicioni i "Drejtores së Drejtorisë" në pozicionin e "Specialistes". Me vendimin nr. 18, datë 05.01.2016, UKT sh.a ka zgjidhur marrëdhënien e punës me ankuesen, për shkak të suprimimit të pozicionit të punës. Në këto kushte, ankuesja ka pretenduar përpara KMD-së se, fakti që ajo është ekspozuar haptazi dhe publikisht për shkak të bindjeve të saj të djathta, ka bërë që Drejtoria e Përgjithshme e UKT-së, të marrë vendimin për largimin e saj nga pozicioni i punës që mbante.

Në zbatim të parashikimeve ligjore të përcaktuara në nenet 32, pika 2 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen, duke kryer verifikimet e nevojshme dhe analizën e situatës, e cila citohet në vijim. Me shkresën nr. 95/1 prot, datë 28.01.2016 të Komisionerit, është njoftuar UKT për fillimin e procedurave të shqyrtimit të ankesës, duke iu kërkuar

informacion mbi pretendimin e ngritur nga znj. [REDAKTUAR] rikërkuar informacioni me shkresën me nr. 5/2 prot, datë 23.02.2016 të Komisionerit. Me shkresën me nr. 5420 prot, datë 07.03.2016, UKT sh.a ka informuar Komisionerin lidhur me pretendimin e ankueses dhe ka parashtruar argumentet e veta lidhur me lirimin nga detyra të znj. [REDAKTUAR], pa paraqitur dokumente provuese bashkëlidhur. Në vijim të procedurës për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, me datë 04.04.2016, në zbatim të urdhrin nr. 54, datë 30.03.2016, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, realizoi një inspektim pranë UKT Tiranë. Grupi i inspektimit të Komisionerit u takua me Drejtorin e Burimeve Njerëzore dhe sipas dakordësimit të palëve, me shkresën me nr. 7132/1 prot, datë 11.04.2016, UKT sh.a ka dërguar pranë Komisionerit dokumentacion lidhur me ankuesen, por pa përmbushur kërkesat e lëna në urdhrin e inspektimit.

Në zbatim të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, sipas nenit 33, pika 8, me datë 22.04.2016, Komisioneri realizoi një seancë dëgjimore mes palëve. Seanca u zhvillua me praninë e të dy palëve. Ankuesja parashtroi të njëjtat argumente si në ankesë, lidhur me pretendimin se vendi i Drejtorit të Drejtorisë së Shitjeve dhe Faturimit nuk është suprimuar dhe se në këtë pozicion është emëruar një punonjës tjetër, i cili sipas ankueses nuk ka arsimin përkatës për këtë pozicion pune, si dhe është punonjës i marrë nga jashtë strukturës së UKT-së. Znj. [REDAKTUAR] ka theksuar faktin që ajo ka qenë e ekspozuar politikisht dhe ky është shkak i vërtetë i largimit të saj nga puna. UKT sh.a parashtroi se e gjithë procedura e ndjekur për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për shkak të ristrukturimit është kryer në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi dhe si rrjedhojë nuk ka ardhur si pasojë e diskriminimit politik siç pretendon ankuesja, pasi dëshmitë për bindjet politike të punonjësve nuk janë pjesë e dokumentacionit të dosjeve të tyre. Lidhur me pretendimin e ankueses se është zëvendësuar nga një person që nuk plotëson kriteret e kërkuara për atë pozicion pune dhe se vendi i saj nuk është shkurtuar, si dhe kërkesës së Komisionerit për t’u njohur me dokumentacion shtesë, përfaqësuesit e UKT-së u përgjigjën se do ta sjellin shkresërisht, në rrugë postare.

Me shkresën nr. 487 prot, datë 29.04.2016 të Komisionerit, është kërkuar informacion shtesë nga UKT-ja, për pyetjet dhe dokumentacionin e kërkuar në seancën dëgjimore të datës 22.04.2016. Me shkresën nr. 10011/1 prot, datë 23.05.2016, UKT sh.a ka sjellë shkresërisht përgjigjen e hartuar nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, e cila sipas KMD-së nuk është vlerësuar të ketë qenë e plotë dhe rezulton me mangësi informacioni për disa nga pikat që Komisioneri ka vlerësuar si të nevojshme për sqarimin e çështjes së znj. [REDAKTUAR]

Në përfundim të hetimit administrativ, pasi ka mbledhur informacionin e nevojshëm dhe ka vlerësuar në referim të ligjit situatën e ankueses, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi me vendimin nr. 165, datë 14.11.2016, ka vendosur: “1. Konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë, për shkak të bindjeve politike të znj. [REDAKTUAR] nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të shoqërisë UKT sh.a; 2. Referuar pikës 1 të këtij vendimi, të merren masa të menjëherëshme nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Shoqërisë UKT sh.a, për rikthimin në punë të znj. [REDAKTUAR] 3. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë UKT sh.a, të njoftojë Komisionerin,

lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi; 4. Në referim të nenit 33, pika 11. të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi". moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13. të po këtij neni; 5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë, brenda afateve ligjore. Vendimi i mësipërm nr. 165, datë 14.11.2016 i është komunikuar UKT sh.a me shkresën e KMD nr. 95/4 prot. datë 14.11.2016.

Në këto kushte, pala paditëse më datë 25.11.2016, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me padinë objekt gjykimi.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, pasi ka marrë në shqyrtim çështjen me Vendimin Nr. 970 (80-2017-996), Dt.13.03.2017, ka vendosur:

- Pranimin e padisë së palës paditëse "Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a.
- Shfuqizimin e vendimit nr. 165, datë 14.11.2016 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Ky vendim përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutimi i detyrueshëm bëhet nga përmbartuesi gjyqësor.
- Shpenzimet gjyqësore janë në ngarkim të palës së paditur.
- Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë brenda 15 ditëve nga e nesërmya e shpalljes. Për Avokaturën e Shtetit në mungesë ky afat fillon nga e nesërmya e njoftimit të vendimit.

Gjykata ka arsyetuar se:

".....Lidhur me thelbin e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata analizon pretendimet e palëve në referim të kuadrit ligjor dhe gjendjes së provave të administruara në gjykim.

Në nenin 1, të ligjit nr. 10221/2010, parashikohet objekti i ligjit sipas të cilit: "Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër".

Në vlerësim të nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010, ankesa e shtetases [redacted] është vlerësuar nga KMD se përmban elementët formal të kërkuar nga ky ligj dhe me të drejtë është proceduar me shqyrtimin e saj. Në nenin 1, të ligjit nr. 10221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", përcaktohet një listë joshteruese shkaqesh diskriminimi, ku "bindja politike" është një nga shkaqet e parashikuara për të cilin Ligji ofron mbrojtje. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në kompetencat që i jep ligji nr. 10221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" nuk ka tagër për të dhënë dëmshpërblim, por në nenin 34/1 të ligjit përcaktohet se: "Çdo person ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim për një nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, mund të paraqesin kërkesë padi përpara gjykatës kompetente sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile

për dëmshpërblim sipas ligjit ose sipas rastit, të kryejnë kallëzim përpara organeve kompetente për ndjekje penale”.

Në nenin 37, pika 1, të këtij ligji, parashikohet se: “Vendimi i gjykatës cakton dëmshpërblim nëse gjykata vendos që ka shkelje të këtij ligji, duke përfshirë edhe një afat kohor për kryerjen e zhdëmtimit”. Po kështu, neni 38 i po këtij ligji parashikon se: “Dëmshpërblimi përfshin ndër të tjera, ndreqjen e shkeljeve ligjore dhe të pasojave të tyre përmes kthimit në gjendjen e mëparshme, kompensimin e duhur për dëmet pasurore dhe jo pasurore ose përmes masave të tjera të përshtatshme”.

Ankuesja ka pretenduar kthimin në gjendjen e mëparshme, nëpërmjet konstatimit të diskriminimit në zgjidhjen e kontratës së punës dhe KMD është shprehur në vendimin e saj për marrjen e masave për kthim në punë nga punëdhënësi. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në përfundim të hetimit të tij administrativ, ka arritur në përfundimin se ndryshimi i pozicionit të punës dhe paligjshmëria e veprimeve të ndërmarra nga ana e strukturave të UKT-së, në dëm të ankuseses, kanë sjellë për pasojë edhe vendosjen e saj në kushte të disfavorshme, duke e larguar nga puna pa shkaqe të arsyeshme dhe duke e trajtuar në mënyrë të diferencuar nga pjesa tjetër e punonjësve. Sipas KMD-së, largimi i znj. [REDAKTUAR] nga puna, nuk lidhet drejtëpërdrejtë me ndryshimet e pësuar në strukturën e Shoqërisë UKT sh.a, duke shprehur Komisioneri bindjen se zëvendësimi i ankuseses ka qenë tendencioz dhe i bazuar në kritere preferenciale dhe jo mbi argumente ligjore, masa të arsyeshme dhe proporcionale.

Komisioneri në arritjen e këtij përfundimi ka analizuar disa aspekte që lidhen me ecurinë e marrëdhënies së punës së ankuseses znj. [REDAKTUAR] dhe konkretisht: “i. Ecurinë e karrierës në punë të ankuseses dhe efektet e vendimeve të drejtorit të ri të UKT sh.a, në analizë si të shkaqeve të servirura dhe të parametrave kohorë. KMD pasi liston pozicionet e punës së mbajtura nga ankuesja që në kohën e fillimit të detyrës pranë UKT me datë 22.06.2006, fillimisht si “Ekonomiste në Njësinë e Prokurimit” e deri në funksionin e Drejtores së Drejtorisë së Shitjeve dhe Faturimit (me vendimin nr. 1216, datë 10.09.2013), konkludon se karriera e ankuseses ka ardhur në rritje të vazhdueshme që nga momenti i punësimit të saj në UKT. Komisioneri arsyeton se me vendimin nr. 605, datë 27.10.2015 ankuesja kalon nga pozicioni i drejtores në atë të “Specialistes ekonomiste” në Departamentin e Shitjes, duke pësuar kështu jo vetëm ndryshim të vendit të punës por edhe të pagës, e cila është ulur në një masë të ndjeshme; ii. Mungesën dokumentare dhe në pasojë të provueshmërisë së shkakut të servirur nga UKT sh.a, i cili justifikon kalimin e të znj. [REDAKTUAR] në një pozicion më të ulët, si dhe zëvendësimin e saj me një person tjetër, me argumentin se drejtoria që drejtonte znj. [REDAKTUAR] për vitin 2015 ka pasur mosrealizim të planit vjetor të të ardhurave, gjë e cila ka çuar në përkeqësimin e treguesve ekonomiko-financiar të UKT-së. KMD ka argumentuar në vendimin e saj se, nuk është provuar me asnjë shkresë që mosrealizimi i planit vjetor të të ardhurave nga ana e drejtorisë që drejtonte znj. [REDAKTUAR], ka çuar në përkeqësimin e treguesve ekonomiko-financiar të UKT-së e po ashtu, UKT-ja nuk solli asnjë dokument provues për z. [REDAKTUAR] lidhur me kualifikimet apo procedurën e emërimit të tij në këtë pozicion, në vend të ankuseses; iii. Argumentimin e paligjshmërisë mbi shkakun e servirur për pushim kolektiv nga puna. Sipas KMD-së, nëse do ishte situata e pushimit kolektiv, UKT-ja do të duhej t'i kishte

dhënë përparësi rimarrjes në punë të punëmarrësve të pushuar nga puna, për arsye që nuk kanë të bëjnë me punëmarrësit, nëse ai punëson punëmarrës me kualifikim të krahasueshëm. Në rastin e znj. [REDAKTUAR] nuk është respektuar ky parashikim pasi UKT është shprehur se ka suprimim të vendit të punës, ndërkohë që rezultojnë që vendi i specialistit ekziston, provuar me emërimin e një tjetër personi datë 12.04.2016, pra pas miratimit të strukturës së re të UKT-së, me vendimin nr. 05, datë 04.04.2016 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve. KMD ka konkluduar se UKT sha ka bërë dhe emërim të tjera pas periudhës së pushimit kolektiv". Në analizë të rrethanave të verifikuara, Komisioneri ka vlerësuar se shkak për largimin nga puna të ankueses kanë qenë bindjet e saj politike, qartësisht të provuara. Nga ana tjetër, UKT sh.a argumenton se prej saj është kryer procedura e largimit kolektiv nga puna sipas nenit 148, të Kodit të Punës për një numër të konsiderueshëm punonjësish përfshirë edhe znj. [REDAKTUAR] në pozicionin e punës dhënë së fundmi. Gjykata vëren se në praktikën dokumentare të sjellë para saj nga të dy palët ndërgjyqëse, rezultojnë shkresa me nr. 23675/2 prot, datë 26.11.2015 e Drejtorit të Përgjithshëm të UKT-së, N. Gjojdeshi drejtuar Asamblesë së Aksionerëve të UKT-së, me lëndë: "Relacion për miratimin e projekt-vendimit "Për ndryshimin e strukturës dhe organigramës së shoqërisë", në të cilën ndër të tjera thuhet se: "...Nga vëzhgimet e deritanishme rezultojnë se pjesa dërrmuese e emërimeve të viteve të fundit është bërë në bazë të orientimeve politike, pa vlerësuar kualifikimet që kërkon kjo kompani. Në këto kushte propozojmë që numri i punonjësve nga 1300 që është miratuar të ulet në 863 punonjës...". KMD referon në vendimin e saj se, lidhur me sa thuhet në këtë shkresë, nuk është argumentuar as hedhur poshtë me prova nga UKT-ja. Ky dokument është konsideruar si akt provues mbi situatën e pretenduar të diskriminimit për bindje politike në rastin e ankueses.

Gjykata vëren se relacioni i sipërcituar nr. 23675/2 prot, datë 26.11.2015 i Drejtorit të Përgjithshëm të UKT-së (i emëruar pas ndryshimit të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës), i drejtohet Asamblesë së Ortakëve të UKT sh.a, në të cilën ka motivuar mbingarkesën e administratës së shoqërisë, në raport me gjendjen e saj tekniko financiare dhe me të cilën është paraqitur për miratim projekt vendimi për miratimin e strukturës së re organike dhe organigramës së shoqërisë. Në vijim, me vendimin nr. 25, datë 09.12.2015 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve të UKT sh.a, është vendosur miratimi i numrit të përgjithshëm të punonjësve të UKT sha prej 864 veta, si dhe i strukturës së re organizative. Në datë 11.12.2015 me shkresën nr. 24772 prot, Drejtori i Përgjithshëm i UKT-së i dërgon sindikatës së punonjësve të UKT sh.a njoftimin për pushim kolektiv. Në datë 14.12.2015 është mbajtur procesverbali mbi minutat e takimit për këshillimet me sindikatën e pavarur të punonjësve të UKT sh.a, mbi pushimin kolektiv, në të cilin Drejtori i Përgjithshëm i UKT-së dhe përfaqësues të sindikatës, kanë rënë dakord mbi kriteret për t'u ndjekur në përcaktimin e punonjësve që preken nga pushimi kolektiv, ku janë cituar; (a) vjetërsia në punë, (b) kualifikimet e punonjësve (c) performanca në punë. Në po këtë datë, është nënshkruar marrëveshja kolektive për pushim nga puna midis UKT sh.a dhe sindikatës së pavarur të punonjësve të UKT sh.a, ku në nenin 3, pika 2.3 të saj janë listuar tre kriteret e sipërcituara që do të ndiqen për pushimin kolektiv nga puna.

Me shkresat nr. 24772/1 prot, datë 14.12.2015 dhe nr. 24772/2 prot, datë 16.12.2015, është njoftuar Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë për fillimin e këshillimeve për pushimin kolektiv të punonjësve.

Gjykata vëren se veprimet e sipërcituara të ndërmarra nga pala paditëse, referojnë në nenin 148, të Kodit të Punës mbi procedurën e nevojshme për t'u ndjekur për pushimin kolektiv, për të cilin standardi i ligjit parashikon vetëm raportin midis personave të pushuar në raport me numrin e punonjësve në ndërmarrje. (neni 148, pika 1, të Kodit të Punës). Vlerësimi i nevojës për pushim kolektiv është në diskrecion të punëdhënësit, pasi ligji nuk vendos kondita mbi arsytet e pushimit kolektiv dhe Asambleja e Përgjithshme të Aksionerëve të UKT sh.a, në funksion të kësaj ka vendosur miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të UKT sh.a, i cili mbetet prej 864 vota. UKT sh.a paraqiti listën e personave të cilët janë pushuar nga puna për shkak të shkurtimit/ suprimimit të pozicionit të punës (mbi 340 të tillë), ku rezultojnë edhe emri i ankueses [redacted] dhe nga ku rezultojnë se janë prekur pozicione të ndryshme të punës, si nga administrata e UKT sh.a, ashtu edhe nga njësitë 2, 3, 4 dhe 5 të saj.

Gjykata vëren se bindjet politike të punëmarrësit janë një e drejtë e tij e lirë për t'u ushtruar sa kohë nuk ndikojnë në rregullsinë e përmbushjes së detyrimeve kontraktore në funksion të punës së ushtruar. Vetëm fakti që një shtetas i punësuar provon të ketë përkatësi politike apo/ dhe angazhime të kësaj natyre, në ushtrimin e të drejtës së tij kushtetuese, nuk është argument që do të justifikonte praninë e motivit diskriminues për bindje politike në rastin e largimit të tij nga puna. Nëse kjo do të ndodhte, atëherë subjektet punëmarrëse me të drejtë do të frenoheshin në punësimin e këtyre shtetasve, për shkak të pamundësisë së zgjidhjes së kontratës, pa u prekur nga efektet e nenit 146, të Kodit të Punës. Fakti që ankuesja është anëtare e Partisë Demokratike, nuk e vendos atë apriori në një pozitë më të mbrojtur në raport me tërësinë e punonjësve të tjerë të UKT sh.a, të cilët gjithashtu janë larguar nga puna dhe KMD nuk ka konkluduar nëse të gjithë punonjësit e larguar janë anëtarë me kartë anëtarësimi në një parti politike.

Relacioni për miratimin e projekt-vendimit me lëndë: "Për ndryshimin e strukturës dhe organigramës së shoqërisë", drejtuar asamblesë së aksionerëve të UKT-së me shkresën nr. 23675/2 prot, datë 26.11.2015 nga Drejtori i Përgjithshëm i UKT-së, konfirmon se nga vëzhgimet ka rezultuar se pjesa dërrmuese e emërimeve të viteve të fundit është bërë në bazë të orientimeve politike, pa vlerësuar kualifikimet dhe mbi këtë bazë është propozuar që numri i punonjësve nga 1300 që është miratuar të ulet në 863 punonjës. Akti në fjalë është interpretuar literalisht nga pala e paditur, se konfirmon pushimin e ankueses për shkak të bindjeve të saj politike, kur në fakt relacioni vë theksin mbi mungesën e rekrutimit në detyrë mbi baza kualifikimesh, për shkak se ka patur emërime mbi orientime politike.

Rëndësia e këtij relacioni nuk prevalon ndaj marrëveshjes kolektive për pushim nga puna midis UKT sh.a nëpërmjet Drejtorit të Përgjithshëm të saj dhe sindikatës së pavarur të punonjësve të UKT sh.a, ku në nenin 3, pika 2.3 të saj janë listuar tre kriteret për t'u ndjekur për pushimin kolektiv nga puna që janë: (a) vjetërsia në punë, (b) kualifikimet e punonjësve, (c) performanca në punë. Gjykata sjell në vëmendje se UKT sh.a nuk justifikoi që këto tre kriteret (për mbajtjen në detyrë) të gjenden të justifikuar dhe të pranishme tek personat e tjerë, që nuk janë prekur nga pushimi kolektiv nga puna më shumë sesa tek ankuesja.

rrethanë e cila mund të mos justifikojë ligjërisht mosmarrjen e masave nga UKT për sistemin e ankueses dhe jo të provojë diskriminimin e drejtpërdrejtë të saj për shkak të bindjeve politike.

Nga sa më sipër u arsyetua, gjykata arrin në përfundimin se vendimi nr. 165, datë 14.11.2016 i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk vlerësohet i bazuar në ligj dhe i thelltë, ndaj gjykata vendos shfuqizimin e plotë të tij, duke pranuar padinë e UKT sh.a. ”

Ndaj këtij vendimi ka ushtruar ankim pala e paditur, e cila kërkon ndryshimin e vendimit dhe rrezimin e padisë, për shkaqet e parashtruara në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

Vlerësimi i kolegjit administrativ të apelit

Nga shqyrtimi i çështjes në dhomë këshillimi mbi bazën e dokumenteve, Kolegji i Gjykatës Administrative të Apelit çmon se vendimi 970 datë 13.03.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është rezultat i zbatimit të gabuar të normave procedurale për pasojë ai duhet të priset dhe çështja të kthehet për rigjykim.

Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se, vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë është rrjedhojë i një procesi jo të rregullt ligjor të zhvilluar në shkelje të rënda të rregullave procedurale dhe për këtë shkak vendimi duhet të priset dhe çështja duhet të kthehet për rigjykim për këto arsye:

Nga aktet në dosje rezulton e provuar se

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka marrë në shqyrtim ankesën me nr. 8 regj, datë 19.01.2016, të znj. [REDAKTUAR] kundër Drejtorit të Përgjithshëm të UKT sh.a, me pretendimin për zgjidhjen e kontratës së punës mbi shkakun diskriminues të bindjeve politike.

Sipas informacionit të dhënë, rezulton se znj. [REDAKTUAR] ka lidhur marrëdhënien e punës me UKT-në, me datë 23.06.2006, në pozicionin e “Ekonomistes”. Në rend kronologjik ajo ka ndërruar disa pozicione pune: “1. Me datë 16.01.2007, ka kaluar në detyrën e “Ekonomistes” në Sektorin e Faturimit; 2. Me datë 16.08.2008, ka ndryshuar pozicion pune duke kaluar në detyrën e “Përgjegjëses së Repartit”; 3. Me datë 16.06.2009, ka kaluar në detyrën e “Auditit të Brendshëm”; 4. Për periudhën 28.01.2013 - 11.09.2013, është komanduar “Drejtores e Departamentit të Shitjes”; 5. Gjatë periudhës 11.09.2013 - 28.10.2015, ka ushtruar detyrën e “Drejtores së Drejtorisë së Shitjes dhe Faturimit”; Me datë 15.09.2015, me anë të urdhrin nr. 430, datë 15.09.2015, është komanduar në pozicionin e “Drejtores së Departamentit të Shitjes”, i cili është shfuqizuar me urdhrin nr. 430/1, datë 22.09.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të UKT-së. Drejtori i ri i UKT-së është emëruar në detyrë me datë 16.09.2015. Në më pak se 6 ditë nga fillimi i detyrës, ai ka shfuqizuar urdhrin për komandimin në detyrë të ankueses dhe në një periudhë prej vetëm një muaj nga ky shfuqizim ka ulur në detyrë znj. [REDAKTUAR], duke e kaluar nga pozicioni i “Drejtores së Drejtorisë” në pozicionin e “Specialistes”.

Me vendimin nr. 18, datë 05.01.2016, UKT sh.a ka zgjidhur marrëdhënien e punës me ankuesen, për shkak të suprimimit të pozicionit të punës. Në këto kushte, ankuesja ka pretenduar përpara KMD-së se, fakti që ajo është ekspozuar haptazi dhe publikisht për shkak të bindjeve të saj të djathta, ka bërë që Drejtoria e Përgjithshme e UKT-së, të marrë vendimin për largimin e saj nga pozicioni i punës që mbante.

Në zbatim të parashikimeve ligjore të përcaktuara në nenet 32, pika 2 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen, duke kryer verifikimet e nevojshme dhe analizën e situatës, e cila citohet në vijim. Me shkresën nr. 95/1 prot. datë 28.01.2016 të Komisionerit, është njoftuar UKT për fillimin e procedurave të shqyrtimit të ankesës, duke iu kërkuar informacion mbi pretendimin e ngritur nga znj. [REDAKTUAR] rikërkuar informacioni me shkresën me nr. 5/2 prot. datë 23.02.2016 të Komisionerit. Me shkresën me nr. 5420 prot. datë 07.03.2016, UKT sh.a ka informuar Komisionerin lidhur me pretendimin e ankueses dhe ka parashtruar argumentet e veta lidhur me lirimin nga detyra të znj. [REDAKTUAR] pa paraqitur dokumente provuese bashkëlidhur. Në vijim të procedurës për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, me datë 04.04.2016, në zbatim të urdhrin nr. 54, datë 30.03.2016, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, realizoi një inspektim pranë UKT Tiranë. Grupi i inspektimit të Komisionerit u takua me Drejtoren e Burimeve Njerëzore dhe sipas dakordësimit të palëve, me shkresën me nr. 7132/1 prot. datë 11.04.2016, UKT sh.a ka dërguar pranë Komisionerit dokumentacion lidhur me ankuesen, por pa përmbushur kërkesat e lëna në urdhrin e inspektimit.

Në zbatim të ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi", sipas nenit 33, pika 8, me datë 22.04.2016, Komisioneri realizoi një seancë dëgjimore mes palëve. Seanca u zhvillua me praninë e të dy palëve. Ankuesja parashtroi të njëjtat argumente si në ankesë, lidhur me pretendimin se vendi i Drejtorit të Drejtorisë së Shitjeve dhe Faturimit nuk është suprimuar dhe se në këtë pozicion është emëruar një punonjës tjetër, i cili sipas ankueses nuk ka arsimin përkatës për këtë pozicion pune, si dhe është punonjës i marrë nga jashtë strukturës së UKT-së. Znj. [REDAKTUAR] ka theksuar faktin që ajo ka qenë e ekspozuar politikisht dhe ky është shkak i vërtetë i largimit të saj nga puna. UKT sh.a parashtroi se e gjithë procedura e ndjekur për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për shkak të ristrukturimit është kryer në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi dhe si rrjedhojë nuk ka ardhur si pasojë e diskriminimit politik siç pretendon ankuesja, pasi dëshmitë për bindjet politike të punonjësve nuk janë pjesë e dokumentacionit të dosjeve të tyre. Lidhur me pretendimin e ankueses se është zëvendësuar nga një person që nuk plotëson kriteret e kërkuara për atë pozicion pune dhe se vendi i saj nuk është shkurtuar, si dhe kërkesës së Komisionerit për t'u njohur me dokumentacion shtesë, përfaqësuesit e UKT-së u përgjigjën se do ta sjellin shkresërisht, në rrugë postare.

Me shkresën nr. 487 prot. datë 29.04.2016 të Komisionerit, është kërkuar informacion shtesë nga UKT-ja, për pyetjet dhe dokumentacionin e kërkuar në seancën dëgjimore të datës 22.04.2016. Me shkresën nr. 10011/1 prot. datë 23.05.2016, UKT sh.a ka sjellë shkresërisht përgjigjen e hartuar nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, e cila sipas KMD-së nuk

është vlerësuar të ketë qenë e plotë dhe rezulton me mangësi informacioni për disa nga pikat që Komisioneri ka vlerësuar si të nevojshme për sqarimin e çështjes së znj. [REDAKTUAR]

Në përfundim të hetimit administrativ, pasi ka mbledhur informacionin e nevojshëm dhe ka vlerësuar në referim të ligjit situatën e ankueses. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi me vendimin nr. 165, datë 14.11.2016, ka vendosur: "1. Konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë, për shkak të bindjeve politike të znj. [REDAKTUAR] nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të shoqërisë UKT sh.a; 2. Referuar pikës 1 të këtij vendimi, të merren masa të menjëherëshme nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Shoqërisë UKT sh.a, për rikthimin në punë të znj. [REDAKTUAR] 3. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijoni për këtë vendim, Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë UKT sh.a, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi; 4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni; 5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë, brenda afateve ligjore. Vendimi i mësipërm nr. 165, datë 14.11.2016 i është komunikuar UKT sh.a me shkresën e KMD nr. 95/4 prot. datë 14.11.2016.

Kolegji Administrativ i Apelit, pa i hyrë shqyrtimit në themel të çështjes vlerëson se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka lejuar shkelje të rënda procedurale të tilla që e vënë në pengesë kolegjin të shqyrtojë themelin e çështjes, ndaj ai e ndal arsyetimin e tij në këtë moment procedural.

Parimi i barazisë së armëve nënkupton se, çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes palëve. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykimin civil, atëherë argumentet e njëres palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj për të garantuar një proces të rregullt ligjor, qëndrim ky i mbajtur edhe nga Gjykata Kushtetuese në Vendimin nr. 3, datë 23.01.2014, vendimin nr. 34, datë 25.07.2011 dhe vendimin nr. 23, datë 08.06.2007.

Në vijim të kësaj logjike juridike, konstatohet se, për sa kohë që rezultoi i provuar interesi i shtetasen [REDAKTUAR] në çështjen në gjykim, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë kishte detyrimin për ta thirrur si palë të interesuar, e të zhvillojë në këtë mënyrë një proces të rregullt ligjor, si në aspektin procedural ashtu edhe në atë material disponim i cili gjykatës i buron nga neni 193 të Kodit të Procedurës Civile. Për sa më sipër, në kushtet kur nuk rezulton që gjykata të ketë kryer një hetim të plotë mbi çështjen, orientimin e tyre në lidhje me ndërgjyqësinë dhe as ushtrimin e të drejtës për thirrjen si person të tretë të shtetasit [REDAKTUAR], ky kolegji vlerëson se nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë janë lejuar shkelje të rënda procedurale, për te cilat ligji parashikon shprehimisht pavlefshmërinë e procedurës së gjykimin.

Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se, në kushtet e konstatimit të aspekteve procedurale si më sipër, nuk mund të analizojë dhe të marrë në shqyrtim pretendimet e palëve të cilat kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit material. Të gjitha këto pretendime do të merren në shqyrtim dhe do të analizohen nga gjykata administrative, pasi të orientohet pala në proces që të thërrasë si palë të tretë shtetasin [REDAKTUAR] e cila është ankuesja ndaj vendimeve të ndërmarra nga pala paditëse për të cilat ajo në një procedurë administrative parashitroi kërkesën ankimore pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili në përfundim të hetimit administrativ ka marrë vendimin objekt gjykimi. Në këto kushte ky kolegji vlerëson se nga gjykata nuk janë respektuar rregullat procedurale në lidhje me ndërgjyqësinë, pasi në proces do të duhej të ishte thirrur me cilësinë e personit të tretë ankuesja e procesit administrativ, pasi kjo vendimmarrje është rezultat i ankimit të saj e për pasojë ajo tërheq interesa në këtë proces.

Neni 50 i ligjit nr. 49/2012 parashikon;

Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit në dhomë këshillimi

Gjykata Administrative e Apelit në dhomë këshillimi vendos:

- a) mospranimin e ankimit, në rastet kur ankimi nuk plotëson kushtet e pranueshmërisë dhe gjykata administrative e shkallës së parë nuk e ka bërë një gjë të tillë;
- b) lënien në fuqi të vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë;
- c) ndryshimin e vendimit;
- ç) prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim, në rastet kur shkeljet procedurale janë të rënda dhe për të cilat ligji parashikon shprehimisht pavlefshmërinë e vendimit apo të procedurës së gjyqimit;

Në Nenin 1/2 të Ligjit Nr.49/2012, parashikohet se:

“Dispozitat e këtij ligji plotësohen me parashikimet e Kodit të Procedures Civile, me përjashtim të rasteve dhe për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe”.

Konkretisht, Neni 467/d i K.Pr.Civile parashikon se:

“Gjykata e apelit prish vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe e dërgon çështjen për rigjykim kur:

d) nuk është formuar drejt ndërgjyqësia”.

Këtë qëndrim ka mbajtur edhe kolegji administrativ i gjykatës së lartë në vendimin Nr.00-2014-1978 Vendimi (428) datë 12.06.2014 i cili midis të tjerave arsyteon:

15. Kolegji Administrativ vlerëson se, pretendimet e mësipërme të ngritura në rekurs nga pala e paditur [REDAKTUAR] janë të bazuara në ligj, pasi kërkohet që një akt administrativ të konstatohet absolutisht i pavlefshëm dhe organi administrativ që ka nxjerrë aktin nuk është thirrur si palë në gjykim. Duhet theksuar se në gjykimin e mëparshëm kur shqyrtoheshin bashkë padia dhe kundërpadia Komisioni i Ndarjes së Tokës Mamurras ka qenë i thirrur në gjykim nga paditësi me cilësinë e personit të tretë, por pas kthimit të çështjes nga Gjykata e Lartë, gjykata e shkallës parë, që ka patur si objekt gjykimi vetëm kundërpadinë nuk e ka thirrur më në gjykim këtë Komision si person të tretë, por është mjaftuar me thirrjen në këtë cilësi vetëm të ZVRPP Kurbini, veprim i cili është në kundërshtim me ligji procedural, pasi organi që ka nxjerrë aktin administrativ që kundërshtohet në gjykatë duhet të thirret patjetër si palë në gjykim.

16. Në vitin 2000 i padituri [REDAKTUAR] i ka shitur shtetasit [REDAKTUAR] në pjesë të kësaj prone me sipërfaqe 4.513 m² dhe megjithëse ky shtetas heq të drejta pronësie që i vijnë nga një akt administrativ që kontestohet në një proces gjyqësor, ku ai nuk është thirrur në gjykim, prandaj gjykata e shkallës së parë ishte e detyruar që të zbatonte kërkesat e nenit 193 të K.Pr.Civile, pasi ky shtetas ka interesa për zgjidhjen e çështjes.

17. Në nenin 467/1 germa "d" të K.Pr.Civile është parashikuar se: Gjykata e apelit prish vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe e dërgon çështjen për rigjykim kur nuk është formuar drejtë ndërgjyqësia dhe meqenëse ajo e ka lejuar këtë shkelje të rëndë të rregullave procedurale Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, vendimet e gjykatave duhet të prishen dhe duke u bazuar në vendimin unifikues nr.03/2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë çështja i kalon për rishqyrtim Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila pasi të formojë drejt ndërgjyqësinë duhet t'i hyjë gjyqimit në themel të çështjes.

Ndërsa në vendimin Nr.00-2014- 1548 i Vendimit (277) datë 22.05.2014, kolegji administrativ i Gjykatës së Lartë midis të tjerave arsyeton:

"Në të tilla rrethana të faktit dhe të ligjit, Kolegji Civil vëren se ndërgjyqësia është e gabuar. Gjykata e shkallës së parë, pas shtimit të objektit të padisë me kërkimin për urdhërimin e ZRRPP Kuçovë për të regjistruar pronën objekt gjykimi, meqenëse nuk po dispononte vetë paditësi, me të drejtë ka thirrur kryesisht në cilësinë e personit të tretë edhe ZRRPP Kuçovë. Por, gjatë gjyqimit, paditësi [REDAKTUAR] nuk ka kërkuar të disponojë për thirrjen e kësaj palë në pozitën procedurale të të paditurit, ndonëse me vetë padinë e ngritur prej tij kërkon drejtpërdrejt detyrimin e kësaj pale të regjistrojë truallin në pronësi të tij. Kjo gjendje duhet të sillte gjykatën në një vendimmarrje tjetër lidhur me zgjidhjen e çështjes.

Megjithatë, nisur nga natyra e mosmarrëveshjes në gjykim, gjykata e shkallës së parë ka zbatuar gabim ligjin material dhe për rrjedhojë edhe ligjin procedural kur nuk ka disponuar edhe kryesisht për thirrjen si person të tretë të Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike pranë Ministrisë së Financave, e cila, pas suprimimit të Agjencisë

Kombëtare të Privatizimit, ishte autoriteti shtetëror që, sipas ligjit, kujdeset për mbrojtjen dhe kryen procedurat e privatizimit nëpërmjet tjetërsimit të pronave shtetërore. Në kushtet kur BSPSH nuk ka patur titull pronësie mbi truallin objekt gjykimi dhe as nuk e ka patur të regjistruar atë, paditësi konfliktin për të drejtën subjektive që pretendon në gjykim e ka me Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike pranë Ministrisë së Financave, nga e cila kërkohet dhe bëhet kalimi i pronësisë së truallit pronë shtetërore në pronë private.

Kolegji Civil vëren se në çështjen objekt gjykimi, formimin e gabuar të ndërgjyqësisë nuk e ka riparuar as edhe nga ana e gjykatës së apelit.

Duke u bazuar në sa më sipër, Gjykata Administrative e Apelit, bazuar në nenin 50, germa "ç" të Ligjit Nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", përfundimisht vlerëson se vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë duhet të priset dhe çështja duhet dërguar për rigjykim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, në bazë të nenit 50/ç të ligjit Nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar,

VENDOSI

- Prishjen e vendimit nr. 970 dt. 13.03.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, dhe kthimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë po me tjetër trup gjykues.
- Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë, brenda 30 ditëve nga e nesërmyja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

U shpall sot më 05.02.2020 në Tiranë.

ANËTAR

Amarildo LAÇI

d.v

ANËTAR

Bari SHYTI

d.v

KRYESUESE

Alkelina GAZIDEDJA

d.v

Vërtetohet njësia me origjinalin

KANCELAR

*Kancelari
Leonard Shalaj
Shalaj*